



AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE
DHOMA AMERIKANE E TREGTISË



PRIORITETET STRATEGJIKE TË ZHVILLIMIT TË NJË EKONOMIE KONKURRUESE DHE EFIKASE



CONTENTS

Shtylla 1: Forcimi i Klimës së Investimeve dhe Kornizës Rregullatore	4
Shtylla 2: Forcimi i Masave Antikorrupsion dhe Rritja e Transparencës	5
Shtylla 3: Zbatimi i konsultimeve publike efektive përmes angazhimit faktik të qytetarëve dhe palëve të interesuara	6
Shtylla 4: Zbatimi i një Sistemi Tatimor Modern për Rritjen e Konkurrueshmërisë dhe Tërheqjen e Investimeve	7
Shtylla 5: Forcimi i Kapitalit Njerëzor për të Rritur Konkurrueshmërinë Ekonomike	8
Shtylla 6: Zhvillimi i një Industrie Turistike Konkurruese dhe të Qëndrueshme	9
Shtylla 7: Modernizimi i Sistemit Shëndetësor në Shqipëri	10



AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE
DHOMA AMERIKANE E TREGTISË

Në një moment kur Shqipëria përballet njëkohësisht me mundësi të paprecedentë dhe sfida strukturore të thella, nevoja për reforma të guximshme, të koordinuara dhe vizionare nuk ka qenë kurrë më e madhe. Në një klimë ku konkurrenca rajonale po bëhet gjithnjë e më e fortë dhe dinamika ekonomike globale po transformohet me ritme të shpejta, Shqipëria duhet të veprojë me vendosmëri për të çliruar plotësisht potencialin e saj si një destinacion i qëndrueshëm për investime, inovacion dhe rritje afatgjatë. Kjo është thelbësore jo vetëm për procesin e integritimit në Bashkimin Evropian, por edhe për forcimin e pozicionit të vendit si një partner i besueshëm ekonomik në hapësirën transatlantike.

Ky dokument përfaqëson një vizion të prioriteteve strategjike të politikave që synojnë të nxisin rritjen e konkurrueshmërisë ekonomike të Shqipërisë, të konsolidojnë institucionet e saj dhe të sigurojnë mirëqenie të qëndrueshme për qytetarët. Të hartuara nëpërmjet një procesi të thelluar konsultimi me ekspertët e komiteteve të Dhomës Amerikane të Tregtisë dhe të mbështetura në praktikën më të mira ndërkombëtare, këto rekomandime reflektojnë njëkohësisht sfidat më të theksuara dhe mundësitë strategjike që Shqipëria duhet të shfrytëzojë.

Duke tejkaluar kuadrin e një analize thjesht diagnostikuese, ky raport ofron zgjidhje konkrete dhe me vizion afatgjatë, të strukturuar në shtatë shtylla themelore të reformës: nga përmirësimi i klimës së investimeve dhe forcimi i luftës kundër korrupsionit, te modernizimi i politikave fiskale, zhvillimi i kapitalit njerëzor dhe ndërtimi i një industrie turistike të qëndrueshme dhe me vlerë të shtuar. Vëmendje e veçantë i është kushtuar përfundimit të mekanizmave të konsultimit publik si dhe përmirësimit të sistemit shëndetësor – komponentë kyç për një shoqëri të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Zbatimi i këtyre prioriteteve kërkon vullnet të qartë politik, integritet institucional dhe një partneritet të fuqishëm ndërmjet qeverisë, sektorit privat dhe shoqërisë civile. Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri mbetet e përkushtuar të punojë ngushtësisht me të gjithë aktorët për të çuar përpara këto reforma. Vetëm përmes një bashkëpunimi të thellë mund të ndërtojmë një ekonomi më transparente, konkurruese dhe të qëndrueshme, në përputhje me aspiratat e qytetarëve shqiptarë dhe standardet e Bashkimit Evropian.

SHTYLLA I:

FORCIMI I KLIMËS SË INVESTIMEVE DHE KORNIZËS RREGULLATORE

QËLLIMI: Të maksimizohet potenciali i Shqipërisë si një nga destinacionet më tërheqëse për investime në Evropë dhe lider në Ballkanin Perëndimor, përmes ndërtimit të një klime investimi konkurruese dhe të qëndrueshme, që nxit dhe lehtëson Investimet e Huaja Direkte.

REKOMANDIME:

- » **Harmonizimi i Legjislacionit Shqiptar me Standardet e Bashkimit Evropian**
 - Të miratohet një kuadër ligjor modern dhe i harmonizuar për investimet, në përputhje me acquis-në e BE-së dhe me praktikën më të mira ndërkombëtare.
 - Të sigurohet një mjedis ligjor i parashikueshëm për investitorët, përmes kufizimit të ndryshimeve të shpeshta ligjore dhe ofrimit të rregullave të qarta dhe transparente.
 - Të integrohet një mekanizëm i qartë për shqyrtimin e investimeve, me fokus të veçantë në mbrojtjen e sigurisë kombëtare në sektorë strategjikë si energjia, pasuritë e paluajtshme, teknologjia e informacionit, mbrojtja dhe telekomunikacioni.
 - Zbatimi i objektivave mjedisore të BE-së duhet të jetë i balancuar dhe i ndjeshëm ndaj realiteteve globale. Shqipëria duhet të synojë përafrimin me standardet e BE-së për investime të gjelbra dhe të qëndrueshme, duke ruajtur mundësinë për zhvillim ekonomik të zgjeruar, në partneritet me investitorët amerikanë.
- » **Adresimi dhe zgjidhja e çështjeve të lidhura me pronësinë**
 - Të finalizohet regjistrimi i titujve të pronës në gjithë territorin dhe të adresohen në mënyrë përfundimtare mosmarrëveshjet ekzistuese që pengojnë zhvillimin e investimeve.
 - Të përshpejtohen dhe thjeshtëzohen procedurat e legalizimit dhe të përdorimit të tokës, për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të bizneseve.
 - Të hartohet një strategji kombëtare gjithëpërfshirëse për trajtimin e çështjeve të pronësisë, duke shmangur qasjet fragmentare dhe të rastësishme.
- » **Lehtësimi i Procedurave dhe Rritja e Llogaridhënies Institucionale**
 - Të përmirësohet dhe të zbatohet me efektivitet kuadri ligjor për lejet dhe licencat, duke përfshirë liberalizimin e sektorëve jo-strategjikë dhe eliminimin e kërkesave të panevojshme.
 - Të forcohet kapaciteti institucional dhe të përmirësohet përgjegjshmëria e administratës publike për të ofruar shërbime efikase dhe në ndihmë të biznesit.
 - Të sigurohet që investimet të trajtohen si një prioritet ndërinstitucional, me bashkëpunim të ngushtë mes institucioneve dhe përgatitje të akteve nënligjore praktike dhe të zbatueshme.
- » **Krijimi i Paketave Stimuluese Konkurruese dhe të Parashikueshme**
 - Të ofrohen stimuj të mirëtargetuar për të nxitur rritjen e investimeve që respektojnë parimet ESG, promovojnë eksportet, krijojnë vende pune cilësore, përkrahin zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe lehtësojnë transferimin e njohurive dhe teknologjisë.
 - Të rishikohet kuadri i Partneriteteve Publike-Private (PPP), duke garantuar procedura të hapura, konkurruese dhe transparente. Të ndalohet negociimi direkt dhe të minimizohen modelet ku shteti merr përsipër barrën e plotë financiare, për të shmangur rreziqet fiskale dhe deformimin e konkurrencës.

- » **Strategji Transparente për Inventarin dhe Përdorimin e Aseteve Publike**
 - Të kryhet një inventar i plotë i asetëve publike, përfshirë ato të papërdorura ose përdorur në mënyrë të pamjaftueshme, dhe të vendosen kritere të qarta për mundësinë e shfrytëzimit të tyre nga sektori privat.
 - Të aplikohen procedurat tërësisht transparente dhe konkurruese për çdo formë të privatizimit apo dhënies së asetëve publike, përmes tenderave të hapur dhe me dokumentim të plotë.
 - Të krijohet dhe të mirëmbahet një regjistër publikisht i aksesueshëm i të gjitha asetëve publike, duke mundësuar monitorim të gjerë dhe vendimmarrje të dokumentuara.
- » **Zhvillimi i Mekanizmave Alternativë për Financimin e Investimeve**
 - Të nxitet krijimi dhe rritja e fondeve investuese, kapitalit sipërmarrës, platformave të financimit kolektiv (crowdfunding) dhe instrumenteve të tjera alternative për mobilizimin e kapitalit privat.
 - Të promovohet zhvillimi i një tregu kapital të qëndrueshëm dhe tërheqës për investitorët institucionalë.
 - Të përforcohet kuadri rregullator për fondet e kapitalit privat dhe për instrumentet inovativë të investimeve, në funksion të mbështetjes së sipërmarrjes dhe zhvillimit teknologjik.

SHTYLLA 2:

FORCIMI I MASAVE ANTIKORRUPSION DHE RITJJA E TRANSPARENÇËS

QËLLIMI: Ndërtimi i një klime të favorshme dhe të parashikueshme për investime, përmes forcimit të integritetit institucional, transparencës dhe llogaridhënies. Këto elementë janë thelbësorë për të krijuar besim afatgjatë tek investitorët e huaj, sipërmarrjet dhe qytetarët, duke siguruar një zbatim të besueshëm dhe të vazhdueshëm të masave antikorrupsion. Theksi duhet të kalojë nga miratimi formal i akteve ligjore drejt zbatimit efektiv në praktikë, prodhimin të rezultateve të matshme dhe angazhimit më të thelluar të sektorit privat si partner në këtë proces.

REKOMANDIME:

- » **Zbatimi i Qëndrueshëm i Masave Antikorrupsion dhe Forcimi i Përgjegjshmërisë Institucionale**
 - Vendosja e treguesve të qartë të performancës për matjen e zbatimit të masave antikorrupsion dhe publikimi i raporteve periodike mbi rastet e konstatuara, të ndara sipas institucioneve përkatëse.
 - Përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional midis strukturave që kanë në funksion masat antikorrupsion, për të shmangur mbivendosjen e kompetencave dhe për të rritur efikasitetin në zbatim.
 - Forcimi i transparencës në prokurimet publike dhe shpenzimet buxhetore, përmes publikimit në kohë reale të të gjitha kontratave kryesore dhe transaksioneve financiare të qeverisë.
- » **Forcimi i Transparencës dhe Bashkëpunimit me Sektorin Privat në Luftën kundër Korrupsionit**
 - Zbatimi i programeve të detyrueshme të integritetit për bizneset, të lidhura me përfitimin nga kontratat publike, lehtësitë fiskale dhe stimuj të tjerë shtetërorë.
 - Adresimi në mënyrë sistematike i rreziqeve të korrupsionit në sektorin privat, duke ndërgjegjësuar se fenomeni i korrupsionit nuk kufizohet vetëm në sferën publike por

- kërkon një qasje gjithëpërfshirëse, të koordinuar dhe të orientuar drejt parandalimit dhe ndërhyrjes së synuar.
- Krijimi i një bashkëpunimi shumëpalësh me përfshirjen e sektorit privat, shoqërisë civile dhe medias për të monitoruar përpjekjet antikorrupsion dhe për të forcuar mekanizmat e përgjegjshmërisë publike.
- » **Sigurimi i një Sistemi të Drejtë dhe Transparent të Prokurimeve Publike**
- Reduktimi i ndikimit politik në proceset e prokurimit, nëpërmjet rregullave të qarta për shmangien e konfliktit të interesit dhe forcimit të mekanizmave të mbikëqyrjes së pavarur.
 - Krijimi i një mekanizmi të pavarur dhe me procedura të përsheptuara për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në prokurim, për të garantuar trajtim të barabartë dhe të drejtë për subjektet pjesëmarrëse.
 - Zbatimi i auditimeve, për të identifikuar parregullsitë në vendimmarrjet e prokurimit dhe për të rritur besimin publik në menaxhimin e fondeve publike.
 - Monitorimi i pavarur i zbatimit të kontratave, me fokus në verifikimin e cilësisë, përmbajtjes teknike dhe respektimit të afateve të realizimit.
 - Përcaktimi i procedurave të qarta, transparente dhe të bazuara në evidencë për identifikimin e prioriteteve të prokurimit dhe për shpërndarjen e buxhetit ndërmjet institucioneve publike, në përputhje me objektivat strategjike të zhvillimit kombëtar.
 - Vendosja e skemave të shpërblimit të bazuara në performancë për institucionet publike që demonstrojnë rezultate të matshme në realizimin e investimeve dhe zbatimin korrekt të rregullave të prokurimit.

SHTYLLA 3:

ZBATIMI I KONSULTIMEVE PUBLIKE EFEKTIVE PËRMES ANGAZHIMIT FAKTIK TË QYTETARËVE DHE PALËVE TË INTERESUARA

QËLLIMI: Të sigurohet hartimi i një legjislacioni transparent, gjithëpërfshirës dhe me cilësi të lartë, përmes përfshirjes aktive dhe të strukturuar të qytetarëve dhe grupeve të interesit në proceset e konsultimit publik.

REKOMANDIME

- » **Forcimi i Zbatimit, Transparencës dhe Përgjegjshmërisë Institucionale në Konsultimet Publike**
- Të vendosen mekanizma të qarta dhe të zbatueshëm për të garantuar respektimin e detyrimeve ligjore nga institucionet publike në lidhje me konsultimet publike, duke përfshirë masa konkrete në rast moszbatimi të procedurave.
 - Të përcaktohen kritere të qarta për rastet kur është e nevojshme zgjatja e periudhës së konsultimit, me qëllim garantimin e një angazhimi efektiv dhe përfaqësues të të gjithë aktorëve të rëndësishëm.
- » **Zgjerimi i Fushës së Konsultimeve për të Përfshirë Aktet Nënligjore**
- Të zgjerohet detyrimi për konsultim publik duke përfshirë edhe Vendimet e Këshillit të Ministrave dhe udhëzimet ministrore, në mënyrë që të mbyllen boshllëqet ekzistuese ligjore dhe të mundësohet një proces më gjithëpërfshirës e transparent.

- » **Rritja e Efektivitetit dhe Monitorimit të Platformës së Konsultimeve Publike**
- Të garantohet funksionimi i qëndrueshëm dhe efikas i platformës së konsultimeve publike dhe të forcohet mbikëqyrja aktive e saj për të shmangur injorimin ose mospublikimin e komenteve të palëve të interesuara, përfshirë komunitetin e biznesit.
 - Të vendoset detyrimi ligjor për hartimin dhe publikimin e një Raporti Konsultimi, i cili duhet të përmbajë:
 - o Numrin e akteve të futura për konsultim.
 - o Numrin total të komenteve të marra.
 - o Përqindjen e rekomandimeve të pranuar.
 - Publikimi i këtyre raporteve do të kontribuojë në rritjen e transparencës, forcimin e llogaridhënies dhe rritjen e besimit të publikut dhe aktorëve të interesuar në proces.
- » **4. Përmirësimi i Procesit të Hartimit të Legjislacionit dhe Reformave**
- Të rishikohet dhe të vihet në zbatim një metodologji e qartë dhe e standardizuar për hartimin e legjislacionit, në përputhje me parashikimet e strategjisë së reformës në administratën publike.
 - Të përcaktohet një strukturë dhe procedurë institucionale e mirëpërcaktuar për menaxhimin dhe koordinimin e reformave legjislative.
 - Të sigurohet që çdo projektligj apo reformë të shoqërohet me analiza të thelluara dhe studime të ndikimit, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së ndryshimeve të propozuara.

SHTYLLA 4:

ZBATIMI I NJË SISTEMI TATIMOR MODERN PËR RITJEN E KONKURRUESHMËRISË DHE TËRHEQJEN E INVESTIMEVE

QËLLIMI: Të krijohet një sistem tatimor efikas dhe stimulues, që mbështet rritjen e qëndrueshme të biznesit dhe kontribuon në rikthimin e investimeve të huaja direkte, duke përmirësuar klimën e të bërit biznes në Shqipëri.

REKOMANDIME:

- » **Modernizimi i Legjislacionit Tatimor në Përputhje me Direktivat e BE-së dhe Jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.**
- Të garantohet që kadri tatimor në Shqipëri të jetë konkurrues në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, përmes përafrimit me praktikën më të mira ndërkombëtare.
 - Transpozimi formal i direktivave të Bashkimit Evropian në legjislacionin kombëtar nuk mjafton. Aktet nënligjore duhet të pasqyrojnë qartë jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, duke siguruar zbatim të saktë dhe koherent të normave evropiane.
 - Të bëhet e detyrueshme përditësimi vjetor i akteve nënligjore me vendimet më të fundit të Gjykatës Evropiane, për të shmangur praktikën e veçuar kombëtare që devijojnë nga standardet evropiane.
 - Të promovohen rregulla tatimore të qarta, transparente dhe të favorshme për klimën e biznesit, me synim rritjen e nivelit të pajtueshmërisë vullnetare dhe uljen e mosmarrëveshjeve me administratën tatimore.
 - Të hiqet kategorizimi i tatimpaguesve bazuar në nivelin e xhiros vjetore, pasi ky me-

kanizëm ka nxitur fragmentimin artificial të aktivitetit ekonomik në njësi të ndryshme, me qëllim përfitimin e statusit të “biznesit të vogël” dhe shmangien e përgjegjësive tati-
more të zakonshme.

- » **Hartimi dhe Zbatimi i një Kodi Tatimor të Qëndrueshëm dhe të Parashikueshëm**
 - Të miratohet një kuadër politikash tatimore që siguron stabilitet gjatë gjithë mandatit të një qeverie, duke shmangur ndryshimet e shpeshta ligjore apo proceduriale, të cilat cenojnë klimën e investimeve dhe besimin e biznesit.
 - Të kufizohen ndërhyrjet e paparshikuara dhe të pakonsultuara në sistemin tatimor, pasi këto krijojnë pasiguri ligjore dhe administrative, duke e bërë të vështirë planifikimin afatgjatë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të bizneseve.
- » **Ristrukturimi i Sistemit Tatimor në Funksion të Formalizimit të Ekonomisë**
 - Fokusi i reformave tatimore duhet të zhvendoset nga rritja e normave tatimore drejt zgjerimit të bazës tatimore, përmes përfshirjes së ekonomisë informale në sistemin e rregullt.
 - Të ndërmerren politika të qarta, të qëndrueshme dhe të koordinuara, që promovojnë pajtueshmërinë vullnetare të tatimpaguesve dhe reduktojnë në mënyrë efektive evazionin fiskal.
 - Një sistem tatimor i tillë do të mundësojë rritjen e të ardhurave publike përmes zgjerimit ekonomik, duke krijuar hapësira reale për uljen graduale të normave tatimore dhe duke përmirësuar ndjeshëm konkurrueshmërinë e klimës së biznesit në vend.
- » **Digjitalizimi dhe Rritja e Efiçencës në Administratën Tatimore**
 - Të zgjerohet përdorimi i teknologjive digjitale në të gjitha fazat e administrimit tatimor, përfshirë proceset e raportimit, deklarimit, pajtueshmërisë dhe auditimit, me qëllim rritjen e transparencës dhe efiçencës.
 - Të thjeshtohen procedurat administrative dhe të reduktohet në mënyrë të ndjeshme barra burokratike mbi bizneset, për të garantuar një mjedis më të parashikueshëm dhe më të favorshëm për tatimpaguesit.

SHTYLLA 5:

FORCIMI I KAPITALIT NJERËZOR PËR TË RRIUR KONKURRUESHMËRINË EKONOMIKE

QËLLIMI: Të zhvillohet një forcë punëtore e aftë, dinamike dhe e përputhshme me nevojat e tregut të punës, e cila kontribuon në rritjen e produktivitetit dhe mbështet një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe konkurrues.

KONTEKSTI: Shqipëria përballlet me sfida të vazhdueshme në zhvillimin e fuqisë punëtore, ku bizneset raportojnë shpesh mungesën e fuqisë punëtore të kualifikuar, një kuadër rregullator të vjetëruar që nuk pasqyron trendet moderne të punësimit, si dhe një tendencë të lartë të emigrimit dhe zhvillimit të aftësive jashtë vendit. Një reformë gjithëpërfshirëse e tregut të punës—përfshirë një Kod Pune të përditësuar, planifikim strategjik të fuqisë punëtore dhe bashkëpunim më të ngushtë me sektorin privat—është thelbësore për të rritur produktivitetin dhe për të siguruar rritje ekonomike. Me zbatimin e këtyre masave, Shqipëria mund të ndërtojë një treg pune elastik që mbështet konkurrueshmërinë, inovacionin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

- » **Zhvillimi Strategjik i Kapitalit Njerëzor**
 - Hartimi i një dokumenti strategjik me fokus në zhvillimin afatgjatë të kapitalit njerëzor.
 - Kryerja e një studimi gjithëpërfshirës për të identifikuar nevojat aktuale dhe perspektive të tregut të punës në Shqipëri, me qëllim përafrimin e sistemeve arsimore dhe programeve të formimit profesional me këto kërkesa.
 - Të sigurohet që të rinjtë të pajisen me aftësi praktike dhe njohuri të përafuara me kërkesat e tregut të punës dhe me prioritetet strategjike të zhvillimit ekonomik të vendit.
 - Rishikimi dhe përditësimi i Strategjisë së Punësimit dhe Aftësive të hartuar nga Ministria e Ekonomisë, për të garantuar që ajo adreson në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe efektive objektivat e zhvillimit të kapitalit njerëzor.
- » **Zgjerimi dhe Diversifikimi i Mekanizmave të Financimit për Zhvillimin e Fuqisë Punëtore**
 - Forcimi i mbështetjes financiare për programet e trajnimit profesional, përmes zhvillimit të partneriteteve të strukturuar publike-private, mobilizimit të fondeve të Bashkimit Europian dhe zbatimit të mekanizmave të posaçëm të mbështetjes shtetërore.
 - Përmirësimi i aksesit në financim të qëndrueshëm dhe afatgjatë për arsimin profesional dhe programet e mësimi gjatë gjithë jetës, me qëllim përmirësimin e nivelit të punësimit dhe përshtatjen me nevojat dinamike të tregut të punës.
- » **Modernizimi i Kodit të Punës në Përputhje me Dinamikat Bashkëkohore të Tregut të Punës**
 - Përditësimi i kuadrit ligjor të punës për të reflektuar realitetet e reja të punësimit, duke përfshirë punën në distancë, format fleksibël të kontraktimit dhe modelet digjitale të angazhimit profesional.
 - Inkorporimi i dispozitave që mbështesin punësimin e bazuar në aftësi, si dhe krijimi i mekanizmave që mundësojnë zhvillimin profesional dhe avancimin në karrierë për të gjithë punonjësit.
- » **Përmirësimi i Planifikimit të Fuqisë Punëtore përmes Hartimit të një Strategjie Kombëtare të Aftësive**
 - Krijimi i një kornize të qëndrueshme dhe të strukturuar për vlerësimin e vazhdueshëm të nevojave të tregut të punës, në përputhje me prioritetet zhvillimore të vendit, si turizmi, energjia dhe transformimi digjital.
 - Zbatimi i politikave proaktive për tërheqjen dhe mbajtjen e profesionistëve të kualifikuar, duke implementuar masa që nxisin rikthimin e talenteve dhe krijojnë një mjedis të favorshëm për zhvillimin e karrierës në Shqipëri.
 - Pozicionimi i Shqipërisë si një destinacion i favorshëm për nomadët digjitalë të kualifikuar, duke njohur rolin e tyre si kontribues të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe si promotorë të transferimit të njohurive dhe inovacionit.

SHTYLLA 6:

ZHVILLIMI I NJË INDUSTRIE TURISTIKE KONKURRUESE DHE TË QËNDRUESHME

QËLLIMI: Të nxitet rritja e sektorit të turizmit në Shqipëri përmes fuqizimit të kapaciteteve njerëzore, përmirësimit të kuadrit rregullator dhe modernizimit të infrastrukturës, me synimin për të ndërtuar një industri turistike të qëndrueshme, me vlerë të shtuar dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.

KONTEKSTI: Me rritjen e njohjes ndërkombëtare për potencialin unik të Shqipërisë në turizëm, po bëhet gjithnjë e më e qartë – si brenda ashtu edhe jashtë vendit – se Shqipëria ka të gjitha atributet

për t'u pozicionuar si një destinacion udhëheqës në rajon. Megjithatë, për të shndërruar interesin e përkohshëm në vizita të qëndrueshme dhe për të maksimizuar ndikimin ekonomik të çdo vizite, është e nevojshme më shumë sesa një ofertë e pasur natyrore. Kërkohej një strategji kombëtare e mirëmenduar dhe e zbatuar me përkushtim, e cila synon ngritjen e standardeve të shërbimit, zhvillimin e kapaciteteve njerëzore dhe përmirësimin e infrastrukturës e të kuadrit rregullator. Aktualisht, Shqipëria vijon të renditet poshtë në tregues kyç si shpenzimi mesatar për turist dhe krijimi i një ekonomie turistike të qëndrueshme me vlerë të lartë.

REKOMANDIME:

- » **Konsolidimi i kuadrit formal dhe ngritja e standardeve të cilësisë në sektorin e turizmit**
 - Të zbatohet në mënyrë rigorozë kuadri ligjor për liçencimin dhe çertifikimin e strukturave të akomodimit, agjencive turistike, operatorëve turistikë dhe kompanive të makinave me qira, me synimin për të reduktuar konkurrencën e pandershme nga subjektet informale.
 - Të krijohet një sistem kombëtar akreditimi për ofruesit e shërbimeve turistike, i cili garanton cilësi, siguri dhe besueshmëri në ofrim.
 - Të vendosen mekanizma të rregullt të monitorimit, përfshirë inspektime dhe auditime periodike, për të siguruar respektimin e standardeve të përcaktuara në të gjithë sektorin. Zhvillimi i turizmit bregdetar, duke përcaktuar modelin e vizionit afatgjatë që Shqipëria synon të ndjekë
- » **Zhvillimi i Fuqisë Punëtore dhe Trajnimeve në Turizëm**
 - Të nxiten partneritete funksionale ndërmjet institucioneve arsimore dhe sektorit privat me qëllim modernizimin e kurrikulave në fushën e turizmit dhe mikpritjes, duke reflektuar nevojat reale të tregut.
 - Të zgjerohet oferta e trajnimeve profesionale, me fokus në zhvillimin e aftësive praktike, integrimin e kompetencave digjitale dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj klientit.
 - Të parashikohen mekanizma nxitës (si subvencione apo lehtësi fiskale) për subjektet turistike që investojnë në trajnimin dhe çertifikimin e stafit të tyre.
- » **Përmirësimi i Infrastrukturës dhe Sistemit të Transportit**
 - Të përmirësohet infrastruktura logjistike për bizneset e lidhura me turizmin, veçanërisht për sipërmarrjet agroturistike, duke adresuar sfidat në zinxhirët e furnizimit dhe duke lehtësuar qasjen në tregje.
 - Të realizohen investime të qëndrueshme në modernizimin e infrastrukturës rrugore, sinjalistikës dhe transportit publik në destinacionet kryesore turistike, me synim lehtësimin e aksesit dhe përmirësimin e përvojës së vizitorëve.
 - Të promovohen zgjidhje të transportit të qëndrueshëm, përfshirë shërbime elektrike dhe forma alternative të lëvizshmërisë së "pastër", veçanërisht në zonat me fluks të lartë turistik, me qëllim reduktimin e ndikimit mjedisor dhe përmirësimin e cilësisë së përvojës turistike.
- » **Zgjerimi i ofertës turistike dhe rritja e qëndrueshmërisë së sezonit turistik**
 - Të zhvillohen strategji të dedikuara për nxitjen e turizmit gjatë gjithë vitit, përmes promovimit të përvojave alternative si turizmi kulturor, gastronomik, malor dhe ekoturizmi,
 - Të mbështetet promovimi i trashëgimisë kulturore, kuzhinës tradicionale dhe turizmit rural si komponentë të rëndësishëm të identitetit turistik shqiptar.
 - Të inkurajohen investimet në iniciativa të qëndrueshme turistike, përfshirë zhvillimin e eko-resorteve dhe modeleve të agroturizmit 'nga ferma në tryezë', të cilat angazhojnë komunitetin lokal dhe kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit.

SHTYLLA 7:

MODERNIZIMI I SISTEMIT SHËNDETËSOR NË SHQIPËRI

QËLLIMI: Të afrojë sistemin shëndetësor shqiptar me standardet e Bashkimit Evropian, përmes rritjes së investimeve publike, zgjerimit të aksesit në trajtime bashkëkohore dhe sigurimit të një sistemi rimbursimi transparent, të orientuar drejt rezultateve konkrete për pacientët.

KONTEKSTI: Në kushtet e një paradoksi të qartë mes popullaritetit në rritje të Shqipërisë si destinacion dhe mungesës së përparimit ekonomik të qëndrueshëm, emigrimi i vazhdueshëm i qytetarëve mbetet një sfidë serioze. Ndër faktorët kryesorë që nxisin këtë largim, cilësia e ulët e shërbimeve shëndetësore renditet vazhdimisht ndër më kryesorët. Megjithëse janë bërë disa përparime në fusha të caktuara, treguesit shëndetësorë të vendit mbeten nën mesataren rajonale dhe evropiane. Në këtë kontekst, Dhoma Amerikane e Tregtisë ka krijuar një Komitet të Shëndetësisë, me synimin për të forcuar rolin dhe ndikimin e saj në këtë sektor strategjik për zhvillimin afatgjatë të vendit.

REKOMANDIME

- » **Përmirësimi i Modelit për Përfshirjen e Barnave në Listën e Rimbursimit**
 - Vendosja e një procesi rimbursimi transparent dhe të parashikueshëm, i mbështetur në kritere të qarta, të bazuara në evidencë shkencore, për përfshirjen e barnave të reja në listën e rimbursimit.
 - Zbatimi i një kuadri për Vlerësimin e Teknologjive Shëndetësore (HTA) për të analizuar barnat në bazë të efektshmërisë klinike, kostos dhe ndikimit në shëndetin publik.
 - Përafrimi me praktikën më të mira të Bashkimit Evropian, në mënyrë që procesi i vendim-marrjes farmaceutike në Shqipëri të ndjekë standardet evropiane të transparencës dhe efikasitetit.
- » **Rritja e Investimeve Publike në Sektorin e Shëndetësisë**
 - Rritja e buxhetit të shëndetësisë të paktën në nivelin mesatar të vendeve të rajonit, si një parakusht për garantimin e aksesit në trajtime bashkëkohore dhe efektive.
 - Dedikimi i fondeve të posaçme për fusha me prioritet të lartë shëndetësor, si onkologjia dhe sëmundjet e rralla, duke u orientuar nga modelet e suksesshme të zbatuara në vendet anëtare të BE-së.
 - Prioritizimi i investimeve që promovojnë inovacionin dhe përmirësojnë cilësinë e kujdesit shëndetësor, me synimin që përdorimi i fondeve publike të përkthehet në përfitime të prekshme për pacientët dhe në rritje të efikasitetit të sistemit.
- » **Zbatimi i një Sistemi të Balancuar të Përcaktimit të Çmimeve Referuese.**
 - Përdorimi i një metodologjie të balancuar për përcaktimin e çmimeve referuese, bazuar në mesataren e çmimeve në një grup të përzgjedhur vendesh të BE-së.
 - Sigurimi i çmimeve të drejta dhe të qëndrueshme, të cilat pasqyrojnë vlerën reale të tregut dhe krijojnë kushte për vazhdimësinë e furnizimit me barna nga kompanitë farmaceutike.
- » **Përmirësimi i Digjitalizimit dhe Vendimmarrjes së Bazuar në të Dhëna**
 - Përsheptimi i digjitalizimit të infrastrukturës së kujdesit shëndetësor, për të rritur efikasitetin, transparencën dhe monitorimin e performancës në sistem.
 - Grumbullimi dhe analiza sistematike e të dhënave reale të pacientëve, për të mundësuar ndarjen më të mirë të burimeve dhe implementimin e modeleve të financimit të bazuara në vlerë (value-based healthcare).
 - Zbatimi i mjeteve digjitale për përmirësimin e qasjes, monitorimit dhe raportimit, me synimin për të rritur cilësinë dhe barazinë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore.



AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE
DHOMA AMERIKANE E TREGTISË

PRIORITETET STRATEGJIKE TË ZHVILLIMIT TË NJË EKONOMIE KONKURRUESE DHE EFIKASE